



NR. 82 REP.  
NR. 82 KOL.

1/2

DEKLARATË NOTERIALE

Në Tiranë, sot më datë 23.01.2020 (dy mijë e njëzet), para meje noteres Eriketa KOKOLI, me adresë në Rr. "Sami Frashëri", Pallati i Ri pranë Drejtorisë së Policisë, Kati IV, Tiranë, anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, u paraqit:

**DEKLARUESI: "BANKA e TIRANËS" SH.A.**, regjistruar si person juridik shqiptar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr.12718, datë 03.11.1995, NIPT Nr.J61924008V, që vepron si BANKE me Licensën Nr.07, datë 12.09.1996 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, me seli në Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë, përfaqësuar nga **Drejtores e Departamentit të Rekuperimit të Kredive Biznes, Anduela RABAJ (GJONI)**, e bija e Dashnorit, lindur më 12.02.1981 në Kuçovë dhe banuese në adresën Rr. "Medar Shtylla", Pall. i ndërtuar nga Shoqëria "2T" sh.p.k, Apartamenti Nr.11, Tiranë, mbajtëse e Letërnjoftimit Nr.032070049 dhe nga **Drejtores e Departamentit të Administrimit të Kredive, Aida CENGU**, e bija e Azemit, lindur më 16.02.1970 në Kukës dhe banuese në adresën Rr. "M. Fortuzi", Nd.2, H.14, Ap.3, Tiranë, mbajtëse e Letërnjoftimit Nr.035236532, të dyja madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët deklaruan sa më poshtë vijon:


Shoqëria "BANKA e TIRANËS" Sh.A., i ka akorduar z. Alban XHAFERI, kreditë e mëposhtme:

- 1- Kontratë Kredie Bankare Nr.CO.632/16.04.2013 (ndryshuar me Shtojcat përkatëse), për shumën fillestare 1,000,000 EURO (një milion euro); dhe
- 2- Kontratë Kredie Bankare Nr.CO.692/16.06.2014 (ndryshuar me Shtojcat përkatëse), për shumën fillestare 1,000,000 EURO (një milion euro).

Për të siguruar shlyerjen e këtyre kredive, z. Alban XHAFERI, ka vendosur peng në favor të "BANKA e TIRANËS" SH.A., 162.313 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e treqind e trembëdhjetë) aksione të regjistruara me një vlerë nominale 1,000 Lekë (një mijë lekë) secila të zotëruara prej tij në kapitalin aksioner të shoqërisë "BIRRA TIRANA" SH.A., që përfaqësojnë 14.62% të kapitalit të paguar të kësaj shoqërie. Kjo vërtetohet me:

- Kontratë Pengu mbi Aksionet Nr.1261Rep/Nr.792Kol, datë 23.06.2014 redaktuar nga Notere Eriketa KOKOLI;

dhe


 - Kontratë Dhurimi Nr.3916Rep/Nr.897Kol, datë 14.11.2019 të Noteres Edlira Hyseni dhe Deklaratë Noteriale Nr.2602Rep/Nr.1366Kol datë 13.11.2019 për dhënien e pëlqimit nga Banka, redaktuar nga Notere Eriketa Kokoli, të depozituara pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 25.11.2019 dhe regjistruar në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve, sipas shkresës me objekt Konfirmim Pengu Nr.20Prot, lëshuar nga kjo e fundit më datë 13.01.2020, me numër llogarie LBNXHFD0770.

Duke qenë se aksionet e z. Alban XHAFERI, janë vënë peng në favor të “BANKA e TIRANËS” SH.A., si dhe në kushtet kur kreditë e dhëna, janë shlyer plotësisht, **me këtë deklaratë autorizojmë Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve dhe Qendrën Kombëtare të Biznesit, të kryejnë veprimet e nevojshme për lirim nga pengu të 162,313 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e treqind e trembëdhjetë) aksioneve të zotëruara nga z. Alban XHAFERI në kapitalin aksioner të shoqërisë “BIRRA TIRANA” SH.A. dhe të vendosura peng i radhës së parë në favor të “BANKA e TIRANËS” SH.A., sipas Kontratës së Pengut mbi Aksionet Nr.1261Rep/Nr.792Kol, datë 23.06.2014 redaktuar nga Notere Eriketa Kokoli.**

Kjo Deklaratë Noteriale u përpilua nga unë Noteri në 5 (pesë) origjinale konform vullnetit të lirë të Deklaruesve, të cilëve pasi ju lexua me zë të lartë dhe pasi e gjetën sipas vullnetit të tyre, e nënshkruan rregullisht para meje NOTERIT.

**DEKLARUES**  
**“BANKA e TIRANËS” SH.A.**  
*përfaqësuar nga:*

  
Drejtoreshë e Departamentit të Rekuperimit të Kredive Biznes

  
Drejtoreshë e Departamentit të Administrimit të Kredive

**NOTERE**  
**ERIKETA KOKOLI**

